Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Përfaqësuesja për Liri të Mediave
Dunja Mijatović

SPEAK UP!2
Liria e shprehjes dhe mediave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi
20 qershor 2013

Fjalim nga Dunja Mijatović, Përfaqësuese e OSBE-së për Lirinë e mediave

Shkëlqesi, zonja dhe zotërinj, të nderuar kolegë dhe miq, Komisioner Fule, ju faleminderit që më ftuat të flasë këtu sot.

Më lejoni që menjëherë të fillojë me porosinë kryesore që dëshiroj ta ndaj me ju sit, meqë koha ime është e kufizuar dhe kemi shumë çështje që dëshirojmë t'i diskutojmë.

Që nga hera e fundit kur pata rastin të flas në këtë ngjarje para dy viteve, gjendja me lirinë e mediave ishte përkeqësuar në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Po aq alarmues është edhe se vullneti politik nga autoritetet, pa të cilin nuk mund të arrihen zhvillime, vazhdon të mungojë.

Sa për t'iu ilustruar qartë situatën, unë kam qenë e detyruar që të ndërhyjë në raste të shkeljeve të lirisë së mediave më shpesh se që kishte ndërhyrë më parë përfaqësuesja e mëhershme e OSBE-së për liri të mediave. Kjo përfshin Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë si dhe shtete të BE-së dhe më gjerë.

Ka shumë lloje të problemeve më të cilat përballen mediumet profesionale dhe situata e përgjithshme nuk është duke u përmirësuar. Kjo duhet t'i aq alarmuese për Vjenën, Strasburgun dhe Brukselin sa edhe për kryeqytetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë. T'ia rikujtojmë vetes se marrëveshjet ndërkombëtare nuk janë opsionale; ato janë obligim për qeveritë pjesëmarrëse.

Në shtetet kandidate dhe kandidate potenciale vazhdimisht kam ngritur çështje para autoriteteve për raste të kërcënimeve apo sulmeve të gazetarëve në publik, të burgosjes për punën e tyre, të rrahjes ngacmimit, mbylljes së mediumeve, dëmtimit apo konfiskimit të pronave të tyre, legjislacionit të mediave të hartuar me nxitim dhe pa transparencë, e kështu me radhë. Disa ligje nuk po zbatohen si duhet; rastet e shpifjeve janë të përhapura dhe, fatkeqësisht, ende po shohim elemente të pandëshkueshmërisë nga ndjekja penale.

Kjo është e rëndë, por në teori, e dimë se çka duhet të bëhet meqë shoqëritë tjera në tranzicion – shumë prej të cilave tani janë anëtare të BE-së – kanë kaluar në përvoja të ngjashme. Përveç që i tërë legjislacioni është përafruar me standardet evropiane, besoj se janë jetikë edhe përkujtuesit tjerë të Komisionit Evropian, Këshillit të Evropës, Zyrës së Përfaqësuesit të Lirisë së Mediave të OSBE-së, dhe akterëve tjerë ndërkombëtarë nga sektori qeveritar dhe joqeveritar.

Po aq jetike janë edhe zërat e shoqërive civile në shtetet në rrezik.

T'i forcojmë këta zëra, t'i mbështetim ata dhe të sinkronizojmë mekanizmat ndërkombëtarë për punën e tyre të rëndësisë së madhe.

Duke iu kthyer çështjes së sundimit të ligjit, ne duhet t'i drejtohemi edhe tek cilësia e legjislacionit dhe mënyrës së zbatimit të tij.

Çka mendoj me këtë? përmirësimi i lirisë së mediave nuk është vetëm çështje legjislacioni. Transparenca dhe përfshirja gjatë hartimit dhe miratimit të ligjeve, si dhe pavarësia e gjyqësorit gjatë zbatimit të tyre, duhet të drejtohen vetëm nja një element thelbësor kur flasim për mediat: ky element është liria.

Nuk është liria për gazetarët apo liria për redaktorët apo botuesit. Liria e shprehjes dhe liria e mediave janë të drejta individuale. Ato janë sikur barasvlerës gojor i *habeas corpus*. Kjo ka nevojë për përpjekje të përbashkëta të shoqërisë civile, politikanëve dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Dhe më lejoni të nënvizoj rëndësinë e madhe të lidershipit politik në këtë proces. Është e qartë se përpjekjet nuk mungojnë – kemi ngjarje, konferenca dhe takime të shumta që mundohen t'i trajtojnë problemet. Për t'i përmendur disa që organizohen këtë vjeshtë: Akademia e së Drejtës së Mediave e organizuar nga RCC, OSBE dhe Friedrich Ebert Stiftung, si dhe konferenca për vetërregullim e organizuar nga UNESCO në Sarajevë, forumi rajonal i organizuar nga SEEMO, si dhe Konferenca për Mediat në Evropën Juglindore që zyra ime është duke e organizuar në Tiranë.

Por të jemi të qartë: ajo që mungon për t'i bërë të gjitha këto përpjekje të vlefshme është vullneti politikë nga qeveritë për ta përmirësuar situatën aktuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Shumë vende thjesht mohojnë faktin e qartë se kanë probleme që lidhen me lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes. Ende dëgjoj nga shumë qeveri që probleme të tilla nuk ekzistojnë në vendet e tyre.

Aspak nuk pajtohem me këtë. Të mohosh se ka probleme vetëm sa krijon pengesa dhe bllokon shtetet nga zhvillimi i mëtejmë.

Shumë shpesh politikanë i shohin mediat si mjete të lojës politike me zjarr, si element i pazarllëqeve politike, si element për të marrë e dhënë.

Kjo është po ashtu e gabuar dhe duhet të ndryshojë. Mediat dhe liria e mediave janë të mira të përbashkëta. Ato janë sikur uji i pastër apo ajri që thithim. Ato i takojnë shoqërisë së tërë.

Kam përshtypjen se ky nocion nuk është kuptuar ende sa duhet në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi.

Kjo është sfidë për lidershipin politik dhe kërkon pjekuri dhe kurajë politike. Dhe është obligim për organizatat ndërkombëtare që ta mbajnë dhe shtojnë presionin në këtë drejtim.

Në të njëjtën kohë, të gjithë elementet e shoqërisë, duke përfshirë profesionistët e mediave dhe OJQ-të, duhet gjithashtu të marrin përsipër përgjegjësi për avancimin e demokracive tona.

Më lejoni që shkurtimisht t'i përvijoj disa raste specifike, meqë jam e sigurt se këto dhe çështje të tjera do të paraqiten më vonë po ashtu gjatë diskutimeve në panel.

Kemi parë sulme të dhunshme dhe kërcënime kundër gazetarëve në të gjithë rajonin, të tilla si ato ndaj Predrag Luçiç dhe Stefica Galiç në Bosnjë dhe Hercegovinë, ose sulmin mbi Olivera Lakiç në Mal të Zi, dhe mosndëshkimi në rastet e Millan Pantiç, Slavko Çuruvija dhe Dada Vujasinoviç në Serbi. Po, ka përmirësime që mund të gjenden gjithandej, dhe kjo është diçka që e pranoj, por kjo nuk mjafton.

Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, gazetari Tomislav Kezarovski është paraburgosur për 30 ditë për një artikull që kishte shkruar.

Dhe tani do të përmend një kategori të re të ngacmimit që po shohim këto ditë në Turqi – përdorimi gati i padallim dhe i tepruar i dhunës nga forcat e zbatimit të ligjit ndaj mediave të cilat kanë raportuar për demonstratat publike.

Në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor gjendja e transmetuesve publikë mbetet kritike dhe pavarësia e rregullatorëve vazhdimisht është sfiduar. Transmetuesit publikë ende nuk gëzojnë liri të plotë redaktuese dhe financiare. Kalimi në transmetim digjital, që ende nuk është realizuar tërësisht në gjithë rajonin, duke rrezikuar kështu krijimin e një vrime të zezë analoge në mes të

Evropës, nuk do të garantojë automatikisht pluralizëm përveç nëse qeveritë nuk nisin veprime për ta siguruar një gjë të tillë.

Bosnja dhe Hercegovina është në proces të futjes së kufizimeve në ligjin e tyre për qasje në informata dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka hartuar në një ligj për media që mund të kufizojë edhe më shumë lirinë e shprehjes. Shqipëria ka miratuar një ligj për transmetimet dhe ende pritet të shihet si zbatimi i tij do të sigurojë lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes.

Pse po ndodhë e tërë kjo?

Do t'i ftoja përfaqësuesit e qeverive të pranishëm këtu sot që të provojnë të na shpjegojnë këtë.

Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias janë vazhdimisht duke siguruar analiza ligjore dhe këshilla të cilat ofrojnë rekomandime se si të përmirësohen dhe harmonizohen ligjet' në shumicën e rasteve, analizat shpërfillen, disa herë as që shqyrtohen nga autoritetet.

Pse po ndodhë kjo?

Kroacia do të bëhet anëtare e plotë e Bashkimit Evropian pas pak ditësh – është lajm i mirë për të gjithë ne, por më duhet të pyes: a i ka përmbushur ky vend të gjitha kriteret e nevojshme për lirinë e mediave?

Turqia.

Çështjet e lirisë së mediave që po i shohim në Turqi janë qartas të një rëndësie shumë më të madhe. Aktualisht janë më shumë se 60 gazetarë në burgje. Po, autoritetet po më thonë se këta njerëz nuk janë futur në burg për aktivitete gazetareske. Unë i dëgjoj autoritetet, por gjithashtu e dëgjoj shoqërinë civile dhe vetë gazetarët. Disa prej tyre madje i kam vizituar në burg.

Dhe pra më duhet të shtroj një pyetje.

Si mund të jetë që kaq shumë gazetarë përballen me akuza për terrorizëm në Turqi? Dhe si mund të shpjegohet bllokimi i vazhdueshëm i afro tridhjetëmijë faqeve të internetit?

Sidoqoftë, vazhdoj të pranoj sugjerime për më shumë trajnime, seminare, shqyrtime ligjore, e kështu me radhë.

Trajnime për çfarë, pyes unë? Këtu në këtë sallë, ka profesionistë tejet shkathtë që nuk kanë nevojë për trajnime por kanë nevojë që të lejohen që ta kryejnë punën e tyre lirshëm. Trajnimet, seminaret, shqyrtimet ligjore duhet të përkrahen, por asgjë nuk do të ndryshojë nëse nuk ka vullnet të fortë politik.

Duke i këta shembuj, pyes veten mos jemi të gjithë mos ne të gjithë jemi të ngujuar në personazhe në storien e gjashtë burrave të verbër dhe elefantit, ku shpeshherë jemi të verbër ndaj perceptimeve të të tjerëve përreth nesh dhe preferojmë ta konsiderojmë lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes vetëm si diçka të cilën e ndjejmë para vetes.

Është me rëndësi të theksojmë se shqetësimet për lirinë e mediave nuk janë specifike vetëm për shtetet kandidate dhe kandidate potenciale. Duhet të jemi të sinqertë dhe të pranojmë se problemet ekzistojnë edhe në disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Në raportin tremujor të cilin e kam paraqitur javën e kaluar para 57 shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, kam ngritur probleme të konsiderueshme të lirisë së mediave në nëntë shtete anëtare të BE-së.

Krahas rrezikut që liria joadekuate e mediave në zhvillimin demokratik të një shteti të caktuar , mospërfillja e vlerave të lirisë së mediave dhe shprehjes së lirë nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian NUK paraqet shembull të mirë për shtet të cilat janë aktualisht në negociata për t'u anëtarësuar në BE.

Pra, ajo që kërkoj unë nga shtetet anëtare të BE-së është që të udhëheqin me shembull dhe pranojnë se liria fillon në shtëpi.

Ajo që kërkoj nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia është një demonstrim të rritur dhe të qartë të vullnetit politik që do të lejojë që mediat të jenë të lira. Ajo që duhet të shihet është thjesht vullneti politik për të mos i përdorur mediat si mjete për përfitime personale dhe të fillohet të tregohet karakteri i liderëve të vërtetë që krijojnë bazë solide për media të lira sot e që do t'i bëjnë ballë testit të kohës.

Organizatat ndërkombëtare shumë shpesh arrijnë së bashku atë që nuk mund të arrijnë vetëm, edhe me qëllimet më të mira. Procesi i integrimit evropian është shembull i kësaj.

Nëse e aplikojmë këtë tek mediat, mendoj se është thelbësore që liria e mediave duhet të mbesë kriter i panegociushëm për kualifikim për integrime evropian. Në këtë kuptim, unë jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë që një gjë e tillë paraqet për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë veten , dhe unë zotohem që do t'i përkujtoj qeveritë për këtë fakt.

Në përmbyllje, më lejoni që edhe një herë të nënvizoj se situata duhet të ndryshojë, dhe atë menjëherë. Që kjo të bëhet e mundur e tëra që duhet, për ta përsëritur përsëri fjalinë e njëjtë, është vullneti politik që kjo të bëhet e mundur.

A do të ndodh kjo? Nuk e di. Kjo është diçka që të gjithë ne do të donim ta dëgjonim sot.

Nuk ka nevojë për shumë ligje të reja. Nuk ka nevojë për punë intensive të komisioneve faktmbledhëse shtesë dhe rregulloreve komplekse për mirësjellje.

Është koha që shtetet të veprojnë, të tregojnë se do t'i përqafojnë vlerat demokratike për të filluar me zgjidhjen e problemeve. Qeveritë duhet të kuptojnë se mënyra e vetme për të ecur para është "me duart larg mediave".

Është po ashtu me rëndësi t'u them gazetarëve dhe punonjësve medialë se nuk mjafton të thuhet "duart larg mediave". Ata duhet të vazhdojnë të angazhohen që të arrijnë profesionalizëm të lartë. E di se kjo më lehtë thuhet se bëhet kur kemi parasysh vështirësitë ekonomike dhe kur vazhdimisht jemi të shtypur apo madje kërcënohen. Por nuk ka rrugë tjetër.

Përsëri, ajo që synojmë ne këtu sot nuk është diçka që një organizatë mund t'ia dalë vetëm. Dhe duke e thënë këtë dua ta falënderoj Komisionin Evropian për organizimin e kësaj ngjarjeje në mënyrë kaq përfshirëse.

Duhet të punojmë së bashku, të ndërtojmë ura, sepse në rrezik janë vlerat tona të përbashkëta. Gjatë përkufizimit të së ardhmes, është me rëndësi të kemi parasysh se roli i mediave është jetik në krijimin e kulturës demokratike. Ky është synimi përfundimtar i së drejtës sonë për fjalë të lirë.

Ju faleminderit.